



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:151327
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06166815

C.nr.449/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. Sh. nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Murati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti pagesa e shpërblimit në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 2,241.64 euro, jashtë seancës, me datë 16.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D. Sh. nga, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, që në emër të licencimit/kualifikimit bachelor t'ia paguaj shtesat në lartësi prej 27 % duke llogaritur me vlerën e pagës bazë, për periudhë 01.02.2023 – 31.12.2023, për 11 muaj, shumën prej 1,746.36 euro, dhe për periudhën 01.01.2024 – 30.04.2024, për 4 muaj, shumën prej 665.28 euro, këto në shumë të përgjithshme të hollave prej 2,241.64 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 02.05.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për pagesën e shpërblimit në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 2,241.64 euro.

Në padi ka theksuar se i njëjti është i punësuar pranë të paditurës sipas kontratës së punës, në pozitën e mësimdhënësit dhe ka kualifikim universitar – bachelor, ndërsa për vitin 2023 ka realizuar pagë bazë prej 588.00 euro dhe për vitin 2024 realizon pagë bazë prej 616.00 euro. Paga bazë e paditëses llogaritet në bazë të koeficientit prej 5.6 dhe vlerës së koeficientit prej 105.00 euro për vitin 2023 dhe 110.00 euro për vitin 2024, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi

për buxhetin e Republikës së Kosovës. Për kualifikim bachelor, paditëses i takon kompensimi shtesë në lartësi prej 27 % të pagës bazë, me ç'rast për vitin 2023 të njëjtës i ka takuar shtesa prej 158.76 euro në muaj, ndërsa për vitin 2024 i takon shtesa prej 166.32 euro në muaj, kurse e paditura nuk ka përmbushur detyrimin e saj ligjor për këtë kompensim të shtesave. Ka argumentuar se paditëses i takon kjo e drejtë në kompensim, pasi përkundër se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik më datë 06.02.2023 është shfuqizuar Vendimi Nr.01/33 i datës 29.08.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka rregulluar këtë kompensim të shtesave sipas kualifikimit; e njëjta shfuqizim nuk është i vlefshëm bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.ref.AGJ.2316/24, KO79/23 të datës 23.01.2024, i cili aktgjykim në pikën VII të dispozitivit ka shpallë të pavlefshëm dispozitat ligjore nga ligji për pagat që kanë shfuqizuar kompensimet për shtesa. Sa i përket mendimit juridik të Gjykatës Supemre të Kosovës, nr.214/23 të datës 09.10.2023, i cili mendim përcakton se vendimi i qeverisë është i vlefshëm deri më datë 06.02.2023, kur edhe ka hyrë në fuqi ligji për pagat, ka theksuar se e njëjta mendim është nxjerrë para se të merrej vendimi i Gjykatës Kushtetuese, prandaj kjo paraqet rrethanë të re dhe paditëses i del baza ligjore për kompensimin e këtyre shtesave të kualifikimit. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën që t'ia kompenojë shumën e përgjithshme prej 2,577.96 euro, të llogaritur në lartësi prej 27 % të pagës bazë, për periudhën kohore 01.02.2023 – 31.05.2024. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.07.2024 ka parashtruar përgjigje në padi, në të cilën kanë theksuar se vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ka theksuar se me të njëjtin është obliguar Kuvendi i Republikës së Kosovës që t'i rishqyrtojë dhe harmonizojë dispozitat ligjore që nuk janë në përputhje me kushtetutën, andaj përderisa kuvendi nuk e ka trajtuar ende këtë ligj, i njëjti vazhdon të prodhojë efekte juridike ashtu siç është. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimin jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësjja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie punë të e paditura (fakt i vërtetuar nga kontratë pune për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, nr.prot.678 e dt.01.09.2013).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka diplomë të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë (fakt i vërtetuar edhe nga diploma e dt.19.05.2014), është mësimdhënës i licencuar (fakt i vërtetuar nga licenca e mësimdhënësit nr.1031533).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu edhe vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë në rastet e kualifikimit-licencimit deri më datë 06.02.2023 është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e paditëses se me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, KO.nr.79/23 të datës 23.01.2024 janë shpallë të pavlefshme dispozitat e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik me të cilat janë shfuqizuar aktet nënligjore që kanë rregulluar çështjen e pagave, kompensimeve, shtesave e shpërblimeve, prandaj në këtë rast gjen zbatim vendimi i qeverisë për kompensimin e kualifikimit, por ka gjetur se ky pretendim është i pabazuar.

Dispozitivi i aktgjykimit të GJK-së, ka gjithsej XIII pika, ashtu që në pikën VII të dispozitivit është e vërtetë se janë shpallë të pavlefshëm paragrafet 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) dhe paragrafin 2 të nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi; mirëpo në pikën VIII dhe X për zbatimin e këtij aktgjykimi është urdhëruar Kuvendi i Republikës së Kosovës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme; dhe në pikën IX është saktësuar se “TË KONSTATOJË se deri në plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës së Kosoves, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i

nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim”.

Nga kjo, gjykata vlerëson se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është drejtpërdrejtë i zbatueshëm vetëm për nëpunësit/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese (neni 2.2, 2.3, 22.2, 24.5, 25.8, 28.7 dhe 42.4 i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik); ndërsa për sektorët e tjerë ku përfshihet edhe paditësja, përkundër se janë shpallë të pavlefshëm këta paragrafë, është paraparë procedurë tjetër ligjore për zbatimin e pavlefshmërisë së tyre. Përkatësisht, është paraparë që të ndërmerren veprime nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të zbatohet aktgjykimi i GJK-së, prandaj në këtë drejtim, gjykata ka gjetur se deri më tani nuk është miratuar ndonjë ligj apo akt nënligjor i ri për të rregulluar çështjen e pagave, kompensimeve dhe shtesave krahas gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e nga kjo rrethanë, nuk ka bazë juridike për njohjen e të drejtës në kompensimin e kualifikimit të kërkuar nga paditësja me këtë kërkesëpadi.

Meqenëse Gjkata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka përcaktuar qartë se deri në ndërmarrjen e veprimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, aktgjykimi KO.nr.79/23 është i zbatueshëm vetëm për nëpunësit e theksuar si më lartë, në të cilën kategori nuk përfshihet paditësja, gjykata vlerëson se nuk është kompetente të zbatojë aktgjykimin e GJK-së, edhe për kategori të tjera, për të cilat ky aktgjykim ka paraparë procedurë tjetër të zbatimit të saj.

Në rastin konkret, në këtë procedurë kontestimore, nuk mund të detyrohet e paditura të kompensojë shtesën për kualifikim paditëses, meqë nuk është rregulluar paprakisht baza ligjore siç detyron Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në fjalë.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.449/24, më datë 16.09.2024

Gjyqtarja,

Numri i lëndës: 2024:151327
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06166815

Valbonë Dërvodeli, d.v

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimet në Gjyke Apelit, përmes këtij Gjykate.